




REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria per Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštë Upravë

-III- Nr. i prot. 16 Më 04.01.2023  
Br. prot.  Dt.   
RAHOVEC - ORAHOVAC



## RAPORTI VJETOR I PUNËS (Janar – Dhjetor 2022)

KOMUNA E RAHOVECIT

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Janë zhvilluar aktivitete në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë. Raport përfshin shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

### Aktivitetet në periudhën: janar - dhjetor

- DSHMS qysh në fillim të vitit 2022 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësive të përshkruara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara;
- Janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit - shëndetësi dhe mirëqenie sociale si: OJQ-të lokale në vlerë prej: **10,700.00 €**, janë përkrahur **2 OJQ** (Hendikos -4.800 € dhe Hareja-5.900 €) të cilat kanë ofruar projekte konkrete;
- Është bërë shqyrtimi dhe përgjigja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale – financiare, prej të cilave : 153 janë të miratuara dhe 199 të refuzuara;
- Në Rahovec është duke funksionuar shërbimi i ri mjekësor (Ekipi Mobil për Kujdes Shtëpiak), që do të lehtësojë marrjen e trajtimit shëndetësor për të moshuarit dhe ata më sëmundje të rënda, për ata që e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja apo QMF-të. Një mjek dhe dy infermierë janë në lëvizje për të ofruar shërbime anembanë Rahovcit nga ora 7:00 deri në 21:00, dhe përveç shërbimeve të tjera ekipi mobil po bën edhe testime rapide për COVID-19. Sipas raportit të mjekut janë kryer **320** vizita mjekësore shtëpiake nga ekipi mobil;
- Në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" është funksionalizuar NUMRIN EMERGJENT 080011008. Ky numër do të jetë pa pagesë dhe funksional, 24 orë.
- Në QKMF "Dr.Fahredin Hoti" në Rahovec, është vënë në funksion aparati i mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostikuar me kohë kancerin e gjirit. Aparati i mamografit vlerësohet të jetë një prej aseteve më me rëndësi për mjekësinë primare, sidomos në aspektin shëndetësor, në parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. Komuna e Rahovcit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave si shtyllë kryesore e familjes dhe mirëqenies së saj;
- Me moton GJAKU I LIRISË në QMF në Krushë të Madhe, u organizua aksioni vullnetar për dhurimin e gjakut, në shenjë nderimi dhe respekti ndaj familjarëve të të rënëve për liri.
- Në ambientet e shkollës "Katër Dëshmorët" në Ratkoc, u bë dhurimi vullnetar i gjakut, për të katërmbehdhetin vit me radhë. Banorë nga Ratkoci dhe fshatrat përreth iu përgjigjen pozitivisht kësaj thirrjeje e cila u dedikohet atyre që humbën jetën në përballje me virusin vdekjeprurës Covid-19.

- Është marrë Vendim mbi caktimin e kujdestarisë për barnatoret në afërsi të QKMF-së "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, me qëllim të përbushjes së nevojave të qytetarëve të komunës së Rahovecit;
- Në dy periudha janë kryer vizita sistematike stomatologjike, nga mjek stomatolog dhe vizita të përgjithshme mjekësore nga mjeku familjar si dhe infermierë - për nxënësit e klasës së I dhe V, ku këto vizita sistematike janë konsideruar si tejet të rëndësishme për shëndetin e fëmijëve-nxënësve tanë;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë gjithsej 3922 thirrje - ftesa për vaksinimin e fëmijeve në komunën tonë;
- Ofrimi i kujdesit shëndetësor specialistik për gra dhe fëmijë në QKMF është: 5979;
- Në Çerdhen e Qytetit, "Tulipanët" në Rahovec, kryhen rregullisht vizitat mjekësore - një herë në javë nga pediatri;
- Në muajin dhjetor është themeluar Këshilli i Pacientëve i përbërë nga 5 anëtarë, mandati i anëtarëve të Këshillit të Pacientëve është 3(tre) vjeçar.

#### Mirëqenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimesh në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimesh në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendorë dhe të huaj, poashtu, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare. Pra, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia. Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

